

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202400700/4

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2024

**Lënda:** Rekomandim për krijimin e mjediseve të përshtatshme për nxënie efektive, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës në shkollën 9-vjeçare "5 Maj" në Bashkinë Dimal

## BASHKISË DIMAL

## DIMAL

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP) bazuar në nenin 13, të ligjit nr. 8454/1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, (ligji nr. 8454/1999) është vënë në lëvizje nga ankesa e nxënësve të shkollës 9-vjeçare "5 Maji" në Bashkia Dimal.

Ankesa e nxënësve ka të njëjtin objekt, konkretisht përmirësimin e infrastrukturës së këtij institucioni arsimor e cila nuk është në përputhje me standardet kombëtare të arsimit. Pretendimet e ngritura në ankesat e tyre konsistojnë në mungesën e laboratorëve të tilla si: TIK-ut, fizikës, kimisë, biologjisë, palestrës dhe pajisjeve mësimore për zhvillimin e lëndës së edukimit fizik, sistemit të ngrohjes etj. Gjithashtu, ata kanë adresuar dhe problematikën e kushteve jashtë standardeve të tualeteve të këtij institucioni edukimi.

AP-ja vitet e fundit ka trajtuar një numër të konsiderueshëm ankesash të cilat lidhen me shkeljen e të drejtave të fëmijëve në fushën e arsimit të adresuara nga vetë fëmijët. Ankesat e tyre më së shumti kanë si objekt problematikat e mjediseve të papërshtatshme infrastrukturore dhe mungesën e pajisjeve dhe mjeteve mësimore për të mundësuar nxënie efektive (kabinetet e lëndëve shkencore dhe sportive).

Shkolla 9-vjeçare "5 Maji" në Bashkinë Dimal është një ndërtesë një kateshë me çati me tjegulla pa korridor lidhës për klasat dhe tualetet. Të gjitha daljet e klasave dhe tualeteve janë direkt në oborrin e shkollës. Oborri i shkollës është shtruar me pllaka betoni në të cilën zhvillohet ora e edukimit fizik, kur koha

është e mirë. Sistemi i ngrohjes realizohet me energji elektrike (furnela) të cilat sigurohen nga vetë nxënësit.

AP-ja filloi hetimin administrativ dhe i dërgoi shkresë për informacion Bashkisë Dimal.

Në përgjigje të shkresës së AP-së me nr. K5/T4-2 prot. datë 07.05.2024, “*Kthim përgjigje*”, Bashkia Dimal ka sqaruar si më poshtë vijon:

*“...Bashkia Dimal i ka kushtuar një rëndësi të veçantë infrastrukturës arsimore duke ndërtuar shkolla dhe kopshte të reja në të gjithë Njësinë Administrative të cilat ndodhen nën juridiksionin e saj.*

*Referuar problematikave të ngritura nga nxënësit e shkollës “5 Maji” ju bëjmë me dije se nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve të Bashkisë Dimal janë kryer riparime dhe mirëmbajtje të pjesshme duke përfshirë tualetet dhe territorin e jashtëm të kësaj shkolle. Bashkia Dimal ka hartuar projektin për rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “5 Maj” dhe jemi në pritje të miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.”<sup>1</sup>*

Për sa më sipër, në vijim të hetimit administrativ, me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave të sipërcituara, AP-ja i ka kërkuar zyrtarisht informacion Ministrisë së Arsimit dhe Sportit(MAS) lidhur me faktin nëse është miratuar projekti për rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “5 Maji” hartuar nga Bashkia Dimal<sup>2</sup>.

Në shkresën me nr.4692/1 prot., datë 14.08.2024 MAS-i informon se:

*“ ...në zbatim të nenit 23, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 28 të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ju bëjmë me dije se, është kompetencë e njësisë bazë të qeverisjes vendore ndërtimi dhe rikonstruksioni i godinave të institucioneve të sistemit arsimor publik, sipas standardeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me burim financimi: fonde nga buxheti i shtetit, fonde nga transferta e pakushtëzuar apo të ardhurat e veta.*

*Në zbatim të ligjit 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, udhëzimit nr.9, datë 27.04.2022 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes për dokumentacionin e nevojshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin e projekteve për*

<sup>1</sup> Shkresa zyrtare me nr.1560/1 prot., datë 14.06.2024 e Bashkisë Dimal

<sup>2</sup> Shkresa zyrtare me nr.K5/I4-4prot., të Avokatit të Popullit

*përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe sportive”, pas shpalljes me urdhërin nr.705, datë 29.12.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit “për shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve nga programet “Arsimi Bazë” “Arsimi i Mesëm” dhe programi “Për Sportin”, pjesë e programit për infrastrukturën shkollore sportive, për projektet me cikël financimi 2024-2025”, Bashkia Dimal me shkresën nr.183/1prot., datë 01.02.2024 “Kërkesë për financim”, protokolluar me tonën nr.882 prot., datë 02.02.2024, ka aplikuar për bashkëfinancim pranë sekretariatit teknik të MAS-it vetëm me projektin “Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare “Haxhi Rustemi” Donofrosë”.*

*Konform legjislacionit të sipërcituar, Bashkia Dimal pas shpalljes së thirrjes nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas drejtimit të thirrjes, duhet të aplikojë pranë sekretariatit teknik në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me projektin e plotë dhe preventivin për rikonstruksionin/ndërtimin e objekteve shkollore.”*

Për sa më sipër nga korrespondenca shkresore, AP-ja konstaton se informacioni i dërguar nga Bashkia Dimal nuk është i saktë, pasi pranë sekretariatit teknik në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit nuk është dorëzuar projekti për rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “5 Maji”, siç pretendon Bashkia Dimal.

Dhënia e informacionit jo të saktë (të gabuar) sjell pengesa në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të AP-së për mbrojtjen e të drejtave, lirive të shtetasve dhe interesave të tyre të ligjshme.

Gjithashtu, dhënia e informacionit jo të saktë përbën shkelje të parimeve kushtetuese dhe ligjore. Kushtetuta e RSH-së, në nenin 63 të saj e ka ngritur në nivel kushtetues detyrimin e organeve të administratës shtetërore dhe funksionarëve publikë, për bashkëpunim me institucionin e AP-së dhe të drejtën e këtij të fundit për të kërkuar informacion e dokumentacion. Parimi i bashkëpunimit në këtë rast është kushtetues dhe detyrues për të gjitha organet e administratës shtetërore, duke i detyruar ato t'i paraqesin AP-së të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, pa përjashtime.

Parimi i bashkëpunimit mes organeve të administratës publike është sanksionuar si në Kodin e Procedurës Administrative, ashtu dhe në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore”. Neni 3 i këtij të fundit përcakton se: “Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e

*institucionet e pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin*". AP-ja është institucion kushtetues i pavarur, ndaj detyrimi për bashkëpunim me AP-në gjatë hetimit administrative është mbi të gjitha një detyrim kushtetues, për nga vetë natyra që ka ky organ publik. Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes.

Për sa më sipër, nisur nga korrespondenca shkresore evidentohet mungesa e bashkëpunimit korrekt të Bashkisë Dimal me AP-në për rastin konkret, duke i dërguar këtij të fundit një informacion jo të saktë.

Referuar problematikës së hasur në këtë rast, AP-ja kërkon nga Bashkia Dimal, titullari i këtij institucioni, të vlerësojë në përputhje me ligjin **organik dhe Kodin e Procedurave Administrative, veprimtarinë e personave përgjegjës mbi përgjegjshmërinë e tyre në shqyrtim të akteve të dërguara nga AP-ja si dhe ofrimin e shërbimeve (përfshi këtu edhe kthimin e përgjigjeve të sakta) konform legjislacionit në fuqi.**

AP-ja vlerëson marrëdhëniet e mira institucionale që ka me institucionet shtetërore, të cilave u drejtohet ky rekomandim, por thekson nevojën për të çuar më tej bashkëpunimin në interes të qytetarëve dhe në rastin konkret të fëmijëve.

Në vlerësim të përgjigjeve zyrtare të organeve të administratës publike (Bashkisë Dimal dhe MAS) dhe bazës ligjore për financimin dhe realizimin e shërbimit arsimor publik, AP-ja konstaton se MAS-i dhe Bashkia Dimal e kanë të qartë rolin e tyre në lidhje me kompetencat dhe përgjegjësitë për të mundësuar bashkërendim të punës lidhur me përmirësimin e infrastrukturës shkollore të arsimit parauniversitar. MAS-i vazhdon të akordojë fonde për ndërhyrje në infrastrukturën shkollore, pajisjen e tyre me bazën materiale dhe materiale didaktike, laboratore shkencore, pajisje kompjuterike apo kabinete informatike duke iu dhënë mundësinë njësisve të qeverisjes vendore të përfitojnë fonde duke aplikuar me projekte-propozime konkrete, të cilat i nënshtrohen procesit të vlerësimit sipas drejtimit të thirrjes.

AP-ja bazuar në rastet e trajtura në vazhdimësi lidhur me përmirësimin e infrastrukturës shkollore me keqardhje ka konstatuar se fondet në dispozicion janë thelbësisht të pamjaftueshme për adresimin e këtyre problematikave. Mbetet i pamjaftueshëm impakti i MAS-it në realizimin efektiv të të drejtës për arsim cilësor, pasi delegimi në pushtetin vendor krijon vështirësi, sidomos për bashkitë me fonde të vogla/pa fonde të mjaftueshme.

Fondet e parashikuara për periudhën 2022-2024, sipas strukturës të grup-artikujve buxhetorë të shpenzimeve për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë në zërin infrastruktura –investimet, planifikimi i fondeve për grupin e shpenzimeve kapitale për këtë periudhë (2022-2024) në arsimin parauniversitar janë parashikuar **17 miliard e 149 milion lekë**, të detajuar për çdo vit të PBA me një rritje mesatare që shkon nga 48.2% në 11.2%. Fondet për investime kapitale në vitin 2022, janë 4 miliard e 231 milion lekë ose 48% e fondeve të miratuar për MAS 2021. Në vitin 2022, ka një rritje prej 1.28 miliard lekë ose 48.3%

- **në vitin 2023** fondet për investime arrijnë në 4 miliard 734 milion lekë ose 12.8% e fondeve të miratuar për MAS me një rritje prej 503 milion lekë ndaj vitit 2022,
- **në vitin 2024** fondet për investime arrijnë në 5 miliard 234 milion lekë ose 10% e fondeve të miratuar për MAS, me një rritje prej 500 milion lekë ndaj vitit 2023 ose 11.3% më shumë se në vitin 2023<sup>3</sup>.

MAS-i ka miratuar aktin nënligjore për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes dhe për dokumentacionet e nevojshme për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin/bashkëfinancimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës shkollore, konkretisht urdhërin nr.705, datë 29.12.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit “për shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve nga programet “Arsimi Bazë” “Arsimi i Mesëm” dhe programi “Për Sportin”, pjesë e programit për infrastrukturën shkollore sportive, për projektet me cikël financimi 2024-2025”, (urdhërit nr.705/2023).

Nga sa më sipër rezulton se MAS-i disponon fonde për investime në arsimin parauniversitar, ku përfshihet arsimi bazë për periudhën 2024-2025. Bashkia Dimal, për rastin në fjalë (shkolla 9-vjeçare “5 Maji”) duhet të hartojë të gjithë dokumentacionin sipas urdhërit nr.705/2023 dhe ta dorëzojë atë pranë sekretariatit teknik në MAS-it.

AP-ja shpreh shqetësimin se një ndër elementët e largimit të të rinjëve nga vendi ynë lidhet dhe me moskrijimin e mjediseve të përshtashme për zhvillimin e procesit mësimor cilësor, sidomos në zonat rurale të vendit.

Arsimi është një e drejtë themelore e njeriut e parashikuar si në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, ashtu dhe në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Autoritetet shtetërore përkatëse duhet të garantojnë që arsimi të jetë i aksesueshëm, me kushte dhe materiale të përshtatshme, klasa, mësues të trajnuar

---

<sup>3</sup>Relacion mbi hartimin programit afatmesëm buxhetor për periudhën 2022-2024, për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, (fq 20)

e kështu me radhë në mënyrë që një arsim cilësor të jetë i disponueshëm për çdo fëmijë.

Ato kanë detyrimin të sigurojnë, që fëmijët dhe të rinjtë të trajtohen si duhet në shkollë dhe të drejtat e tyre të mos shkelen, kjo me qëllim ofrimin e kushteve të përshtatshme jo vetëm për realizimin e procesit mësimor por edhe të veprimtarive me karakter sportiv, edukativ, kulturor e dëfryes, në përshtatje me moshën e tyre<sup>4</sup>.

Ekzistenca e një godine funksionale dhe mirëfunksionimi i mjedisve të brendshme të saj, me mjetet dhe pajisjet e nevojshme, janë të rëndësishme për zhvillimin korrekt dhe sipas standardeve të procesit të edukimit/arsimimit dhe aftësimin fizik të fëmijëve/nxënës<sup>5</sup>. Arsimimi i fëmijës duhet të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të tij<sup>6</sup>. Prandaj, është e nevojshme të merren të gjitha masat, për krijimin e mundësive infrastrukturore të përshtatshme, ku përpos edukimit, t'i nxisim fëmijët edhe drejt një qasjeje të realizimit të plotë të të gjithë orarit mësimor.

Nenet 3, 21 dhe 22, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, parashikojnë se: “... *arsimi parashkollor dhe ai bazë synojnë zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor, zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës... ”.*

Theksojmë se AP-ja është i vetëdijshëm se infrastruktura shkollore mbetet sfidë për njësitë e qeverisjes vendore dhe Ministrinë e Arsimit dhe është gjithashtu në dijeni për buxhetin e kufizuar që ka në lidhje me këtë çështje.

Megjithatë, institucionet shtetërore përgjegjëse duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet dhe të marrin masa konkrete që të inkurajojnë, motivojnë dhe të rrisin cilësinë e arsimimit të fëmijëve/nxënës, nëpërmjet krijimit të kushteve të nevojshme infrastrukturore, si dhe ofrimin të mjeteve të domosdoshme mësimore<sup>7</sup>, me qëllim edukimin dhe aftësimin e fëmijëve. Kjo e drejtë themelore dhe e patjetërsueshme shkon paralelisht edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (konkretisht objektivi 4.1), i cili pohon rëndësinë e sigurimit të një

<sup>4</sup> Shkronja “c”, e pikës 2, të nenit 19, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

<sup>5</sup>“Program mësimor” është dokumenti që përmban synimet, objektivat dhe rezultatet e të nxënës, metodologjitë e të nxënës dhe të vlerësimit për një lëndë ose fushë të caktuar.

<sup>6</sup> Shkronja “a”, e nenit 29, e Konventës të OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës.

<sup>7</sup> Shkronja “e”, e pikës 3, të nenit 18, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

arsimi gjithëpërfshirës, me cilësi të barabartë dhe promovimin e mundësive të të mësuarit përgjatë gjithë jetës. Autoritetet shtetërore deri në vitin 2030, duhet të sigurojnë që të gjithë fëmijët/nxënësit të kryejnë arsimin fillor dhe të mesëm falas, të drejtë dhe cilësor, duke çuar në rezultate të rëndësishme dhe efektive të të nxënit.

Për sa më sipër, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në interesin më të lartë të tyre dhe, në zbatim të legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në fushën e arsimit dhe, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454/1999 AP-ja:

### **REKOMANDON:**

- Marrjen e masave nga Bashkia Dimal për të aplikuar pranë sekretariatit teknik në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me projektin e plotë dhe preventivin për rikonstrukcionin e shkollës 9-vjeçare “5 Maji” bazuar në urdhërin nr.705, datë 29.12.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit “për shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve nga programet “Arsimi Bazë” “Arsimi i Mesëm” dhe programi “Për Sportin”, pjesë e programit për infrastrukturën shkollore sportive, për projektet me cikël financimi 2024-2025”.
- Marrjen e masave për vlerësimin e veprimtarisë administrative, të punonjësve përkatës përgjegjës, të Bashkisë Dimal, lidhur me mospërmbushjen e detyrimit ligjor dhe kushtetues, për t’i kthyer përgjigjen e saktë kërkesave të AP-së, si dhe marrjen e masave organizative që kjo shkelje të mos përsëritet në të ardhmen.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454/1999 organet, të cilave AP-ja u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi!

### **K O M I S I O N E R**

**Olta ALIAJ**